

## NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.65/2018

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal gjyqtari i vetem gjykues Lidija Vucurovic, me sekretare juridike Snezana Vukomanovic, duke vendosur pör çeshtjen penale kundër i akuzuarit [REDAKTUE] Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 2 KPRK-së, duke vendosur për propozimin e shqiptimit të urëdhërit ndëshkimor propozuar në Aktakuzen Prokuroris Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II nr 803/17 nga dt. 01.02.2018, pa e mbajtur shqyrtimit kryesor, me dt. 14.05.2018 e merë këtë:**

### AKTGJYKIM

**APROVOHET:** propozimi te Prokuroris Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II-nr.803/2018 nga dt.01.02.2018. shqiptohet

### URDHËR NDËSHKIMOR

I Pandehuri:

[REDAKTUE], me njofken [REDAKTUE], nga i ati [REDAKTUE] e ema [REDAKTUE] e vajzeris [REDAKTUE] i lindur me 27.11.1989, me vendbanim ne [REDAKTUE] rr. "Sarajevo", e ka kryer shkollen e mesme, i pa martuar, punon ne market, shtetas i Republikes Kosovës, nr. personal [REDAKTUE]

### ËSHTË FAJTORË

**SEPSE:**

-Me daten 24.03.2017 rreth 22:30 ne Mitrovicë, ne afersi te nderteses se komunes gjate kontrollimit të policise te automjetit tipit "Citroen" me targa 02-695-CL te cilin drejtonte [REDAKTUE] ne rrobat e tij eshte gjetur supstanca per cilien dyshohet se eshte narkotik te cilin i pandehuri e posedonte pa autorizim, pas se ciles nga ekspertiza u vertetua se eshte kanabis-marihuana, ngjyr gjelbert- kafe, e cila ne veti permban tetrahidrokanabinol, ne sasi prej 0.72 gr.

-Me këtë ka kryer veprën penale - Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 2 KPRK-së



- Andaj gjykata në bazë të nenit 7, 17, 41, 46, 73 KPK dhe nenit 359.360.365.366 dhe 450 KPP-së i pandehurit:

### SHQIPTON

**DENIM MË GJOBË** në shumë 200 € (dyqind euro), të cilën denim është i obliguar të paguan në afatë prej 15 (pesëmbdhjetë) ditë pas plotëfuqmëris së këtij Aktgjykimi.

-Nese i denuari nuk e paguan dënimin në afat të përcaktuar Gjykata në kuptim të nenit 46 KPK dënimin me gjob do të zavenson me dënim me burrgë ,duke logaritur 20€ (njëzet euro) për një ditë ne burrg.

I denuarit shqiptohet denim shtes konfiskimi i sendit- substances narkotike kanabis- marihuana bis-marihuana, ngjyr gjelbert- njyr kafe, e cila ne veti permbar tetrahidrokanabinol, ne sasi prej 0.72 gr.

I denuarit shqiptohet denim shtese konfiskimi i sendit-substances narkotike Kanabis-marihuana, ngjyr gjelbert- kafe, e cila ne veti permbar tetrahidrokanabinol, ne sasi prej 0.72 gr. si mjet e kryerjes e vepres.

Obligohet dënuari që në emër të shpenzimeve së procedures të paguaj shumen prej 15€ (pesëmbdhjetë) si dhe në emër paushalit gjyqesor shumen prej 15€ (pesëmbdhjet euro) në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqëshmëris së këtij Aktgjykimi,nën krëcnim e eksekutimit të detyruar.

### ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm e ka parashtruar Aktakuzen PP-II.nr.803/17 nga data 15.02.2018, me kërkesen shqiptimit e urdhërit ndëshkimor, kundër te akuzuarit [REDAKTUE] nga Mitrovica, për shkakë të vepëres penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 2 KPRK.

Mbas shqyrtimit të aktakuzës dhe kërkesës së urdhëres ndëshkimor, gjykata gjeti se aktakuza dhe kerkesa për shqiptim e urdherit ndeshkimor janë bazuar dhe në përputhje me neninë 495 par 1 te KPP. Me vështrimit në shkresat të lëndes, e pa mbajtjen shqyrtimit kryesorë te shqiptohn urdher ndeshkimor si ne dispozitiv, gjykata gjeti së egzistojnë prova të mjaftueshme të cilët e vertetojnë fajësin e te denuarit së ai e ka kryer veprën penale me cilen ngarkohet konform nenit 493 par. 1 i 2 KPP.



Gjykata vlersoi se në rastin konkret egzistojnë provat të cilet janë të mjaftueshme për përcaktimin fajësisë të denuarit, se ai e bëri atë vepër penale me cilën ngarkohet sipas Aktakuzes e Prokurorisë. Me vështrim në shkresat të lëndes, kallezim penal nr. 2017-DHTN-178 nda dt. 01.06.2017 raporti policise nga dt. 24.03.2017, procesverbal nga intevista te dyshuarit dhe deshmitarit nga data 27.03.2017, ekspertiza Agjensionit Kosovare Forenzikes- njësia për analizat kimike nga dt. 17.05.2017, vertetimi per konfiskim e sendit nga dt. 24.03.2017, fotodokumentacioni dhe shkresa tjera te lendes, gjykata konfirmoi se ne rastin konkret egzistojn provat per vertetimin e fajesisë te pandehurit se e ka kryer vepren penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore.

Sipak KPK-se per vepren penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga nen 275 par 2 KPRK denimi i parapam eshte denim me gjobe ose denim me burgim deri në një (1) vit.

Në rastin përcaktimit lartesise denimit me gjobë gjykata në pajtim me nenin 73 KPK-së, e ka mare për bazë dispozitën nga nen 275 KPK-së, duke miratuar propozimin prokurorit së shtetit për shqiptimin urdhërit ndëshkimor, denim me gjobë. Gjykata vlersoi se eshtë shqiptuar denim në perputhje me dispozitat ligjore, dhe me të njejtën do të arrihet qellimi i denimit i paraparë më nenin 41 KPK-së, e cila do të ndikonte në rehabilitimin të njejit, parandalim personat te tjera nga kryerja veprave penale, ngritjen vedisimit dhe forcimit detyrimit per respektimit të ligjit. Gjykata gjeti se denimi ishte shqiptuar në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së pandehurit dhe rrezikun social për një veper penale të kryer.

Gjyqtari te pandehurit ka shqiptuar demin shtes per konfiskimin e supstances narkotike marijuane, ngjyre gjelbert-kafe, pesha 0.72 gr, sendi cili ishte perdorur duke kryer vepren penale, ne konform nenit 69 lidhur me nenin 275 par 3 KPRK-se si dhe ne baze te nenit 282 par. 1 nenpar. 2.4 KPP-se.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqsore dhe paushallitë Gjyqsorë eshte bere ne pajtim me nenit 450 KPP.

Në bazë të lartëcekurat është vendosur si në dispozitën e Aktgjykit.

**GJYKATA THEMELORË NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.65/2018 me dt.14.05.2018.**

Procesmbajtsja,  
Snezana Vukomanovic

GJYQTARI,  
Lidija Vucurovic



**KËSHILLI JURIDIKË:** Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ka të drejtë të kundërshtoj me shkrim ose verbal procesverbalin ne këtë gjykate në afatë prej 8 (tetë) ditësh nga data e marrjes së transkriptit të njejtë, e përmes kësaj Gjykate.



Përkthim  
Remzija Colakovic